



Gjatë periudhës janar-shkurt të këtij viti në portin detar të Durrësit janë përpunuar afro 604 mijë ton mallra, ose 160 mijë ton më shumë se dymujori i parë i vitit 2010.

Sipas të dhënave statistikore 46.17 përqind e mallrave të përpunuara gjatë dy muajve të parë të këtij viti janë eksportuar, ndërsa në të njejtën periudhë të vitit paraardhës ishin eksportuar vetëm 35.5 përqind e mallrave të përpunuar në port.

Burimet thanë se mbi 278 mijë ton mallra “made in Albania”, kryesisht çimento, llamarinë, prokate, krom dhe nënprodukte kromi janë nisur drejt porteve të tjera të Evropës. Gjatë kësaj periudhe grosistët dhe transportuesit kanë shfrytëzuar mbi 12 mijë kontejnerë për importet dhe eksportet e mallrave përmes portit detar të Durrësit.

Sipas statistikave portuale importet kanë patur një rritje prej 38 mijë ton, kryesisht në nitrat, ure dhe makineri.

Nga të dhënat statistikore mësohet gjithashtu se tragetet e linjave detare kanë transportuar më shumë 111 mijë ton mallra me kamjonë dhe trajlera, ose 7 përqind më shumë se e njejta periudhë e vitit 2010.

Udhëtarët u rikthehen trageve

Në dy muajt e parë të këtij viti 105.819 udhëtarë kanë shfrytëzuar tragetet e linjave që nisen dhe mbërrijnë në Durrës.

Sipas burimeve të APD shifrat e këtij viti janë 9 përqind më të larta se sa ato të dymujorit të parë të vitit 2010. Rritja e këtij viti lidhet kryesisht me shfrytëzimin e trageve nga ana e udhëtarëve që nisen nga portet e Barit, Ankonës dhe Triestes drejt Durrësit. Shifrat e udhëtarëve që vijnë me trage në Durrës është 33 përqind më e lartë krahasuar me janar-shkurtin e vitit paraardhës-bëjnë të ditur statistikat.

Megjithatë numri i udhëtarëve që mbërrijnë me trage në Durrës është dy herë më i ulët se sa i atyre që i shfrytëzojnë mjetet e mëdha lundruese për tu larguar nga porti shqiptar.

Statistikat bëjnë me dije se gjatë këtij dymujori janë regjistruar 29 lundrime më pak të trageve në nisje dhe mbërritje nga Durrësi.

